



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. 62, datë 20/08 2025

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I DREJTORISË SË
SHËRBIMIT SOCIAL TË BASHKISË BERAT PËR PERIUdhËN
01-31 KORRIK 2025.**

Komisini i Ekonomis, Taksave, DSHS në mbledhjen e datës 20.08.2025, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma "b", 21, 64 gërma "c", të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar datë 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 "Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt te heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 kwh në muaj", VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social", VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027", ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 4 pika 4.

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesës së ndihmës ekonomike për muajin KORRIK 2025, për **99** familje me një fond **360.631** lekë.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.

Bashkëgjitur gjeni listë pagesën e përfituesve për muajin KORRIK 2025,

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA

Komisioni i Ekonomisë, Taksave, DSHS: ____ Vota Pro, ____ Vota Kundër, ____ Vota Abstenim

Adresa: Blvd. "Republika 2", Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935, Website: www.bashkiaberat.gov.al, Email :

bashkiaberat@yahoo.com



**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ / ____ /2025

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN ZNJ.DALLANDYSHE
GURI**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____ . ____ .2025, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerën znj. Dallandyshe Guri në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2025.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të Z.Saimir Guri, djali i së ndjerës që të mundësoj pagesën e shërbimit të varrimit.



4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA

Këshilli Bashkiak e miratoi me: ____ Vota Pro, ____ Vota Kundër, ____ Vota Abstenim